



RAPORT VJETOR 2018



Tabela e lëndës

	Përshëndetja e Presidentit	3
1.	Rrugëtimi i institucionit gjatë vitit 2018	5
2.	Struktura e Urdhrit të Psikologut	7
2.1	Asambleja Kombëtare	8
2.2	Këshilli Kombëtar	9
2.3	Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional.	10
2.4	Administrata e Urdhrit të Psikologut	10
2.5	Komisione të tjera	11
2.5.1	Komisioni i Licencimit	11
2.5.2	Komisioni i Praktikës Profesionale	11
2.5.3	Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji	12
2.5.4	Koordinatorët Lokal	15
3.	Aktiviteti i organeve drejtuese dhe aktet normative të nxjerra gjatë këtij viti	17
3.1	Këshilli Kombëtar	17
3.2	Asambleja Kombëtare	18
3.3	Komisioni i Etikës dhe Gjyimit Disiplinor Profesional	19
4.	Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut	19
4.1	Psikologë të licencuar	20
5.	Ndërtimi i regjistrit elektronik online	21
6.	Trajnimet për psikologët në fushën e drejtësisë	26
7.	Aktivitetet E Urdhrit Të Psikologut	27
8.	Marrëdhëniet kombëtare dhe ndërkombëtare	28
8.1	Marrëdhëniet Kombëtare	30
8.2	Marrëdhëniet Ndërkombëtare	31
9.	Buxheti	32
9.1	Te ardhurat	35
9.2	Shpenzimet	36
10.	Objektivat e realizuar gjatë vitit 2018	37
11.	Objektivat për vitin 2019	38

Përshëndetja e Presidentit



(Dr.Valbona Treska - Presidente)

Kam kënaqësinë të ndaj me ju punën e bërë gjatë vitit 2018 nga Urdhri i Psikologut, i pari vit i plotë që nga ngritja e institucionit.

Gjatë këtij viti kemi bërë të mundur arritjen e disa objektivave mjaft të rëndësishme, të cilat na kanë ndihmuar për të fuqizuar rolin tonë, marrëdhëniet me anëtarësinë, me institucionet kombëtare e ndërkombëtare.

Kemi arritur të realizojmë gjatë këtij viti trajnimin e posaçëm të psikologëve që punojnë në fushën e drejtësisë dhe

për herë të parë, në 14 vite të funksionimit të psikologut në këtë fushë, kemi bërë të mundur ngritjen e një *database* të publikuar dhe përcjellë në çdo institucion të drejtësisë, me psikologët që mund të thirren në proces si vlerësues dhe ata që mund të jenë në rolin e mbështetësit emocional të të miturit (kategori këto të përcaktuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur). Sot të gjitha rajonet e policisë, prokuroritë e gjykatat e të gjitha niveleve në vend, kanë një *database* psikologësh të licencuar e trajnuar specifikisht për të punuar në drejtësi.

Kemi marrë pjesë këtë vit në takimin e anëtarëve të EAWOP të zhvilluar në Torino, Itali, ku kemi bërë një paraqitje të punës së Urdhrit, si dhe kemi shprehur dëshirën e vullnetin për të qenë anëtarë me të drejta të plota të EAWOP në kongresin e Torinës në 29 maj 2019. Ndërkohë që, në takimin e realizuar në Lisbonë, Portugali, me Presidentin e EFPA, Telmo Mourinho Baptista, kemi marrë mbështetjen e tij për mundësinë e anëtarësimit në EFPA në Kongresin që do të mbahet në Moskë gjatë këtij viti. Takimi me homologët tanë të “Ordem dos Psicologos Portugueses” ka qenë gjithashtu ndihmë në marrjen e eksperiencës dhe shkëmbimin e ideve për të përmirësuar punën e institucionit tonë.

Edukimi në vazhdim për psikologët ka qenë një ndër strukturat më të



rëndësishme të ngritura këtë vit nga UP. Një komision i përbërë nga 5 anëtarë do të ketë mundësinë të akreditojë programe trajnimi për komunitetin e psikologëve, ofruar nga institucione, shoqata, qendra, etj.

Urdhri i Psikologut ka patur një anëtarësi që ka ardhur në rritje gjatë këtij viti, por rritja nuk ka qenë ajo që pritej në fillim të vitit, ku synohej që anëtarësia të shkonte të paktën në 1000 anëtarë. Konstatohet se kriteri për antarësinë në UP i vendosur nëpërmjet ligjit 40/2016, që kërkon dy cikle studimi në psikologji, është një element i cili ka ngushtuar komunitetin e perceptuar të psikologëve, të cilët, përpara hyrjes në fuqi të ligjit, ushtronin profesionin edhe vetëm me një cikël studimi në psikologji. Ajo që konstatohet gjatë këtij viti është se komuniteti i psikologëve me dy cikle studimi në fushë, mund të mos jetë aq i gjerë sa ai i pretenduar. Në këto kushte UP-së i lind detyra e menaxhimit të pak të ardhurave që vijnë nga kuotizimi vjetor, çka do të vështirësojë së tepërmi funksionimin e institucionit në vitin 2019.

Pavarësisht këtyre vështirësive financiare të institucionit, pavarësisht vështirësisë së vënies në shina të profesionit, standardizimin e punës, ndryshimet e nevojshme në legjislacion, etj., synojmë që gjatë vitit 2019, të mund të bëjmë hapa të rëndësishëm

cilësor në përfshirjen në organizatat europiane, vendosjen e standardeve tip në profilin e punës së çdo psikologu, rritjen e rolit, si dhe realizimin e provimit të parë të shtetit për këtë profesion. Ne synojmë përfshirjen e psikologut organizacional në kompanitë e rëndësishme shqiptare me numër të lartë punonjësish, por edhe në ato më pak të vogla, por me të njëjtën domosdoshmëri, për të patur të përfshirë në strukturë psikologun e punës dhe atë organizacional.

Ne synojmë që gjatë këtij vitit të rrisim numrin e psikologëve shkollore të përfshirë në sistemin parauniversitar, si dhe të bëjmë të mundur finalizimin e protokolleve të punës për profilet e psikologjisë që praktikohen në terren aktualisht. Të gjitha arritjet e mëdha e të vogla të këtij viti na kanë ndihmuar të shtrojmë rrugën për synimet që kemi vendosur për vitin 2019.

Së bashku po vazhdojmë të ndërtojmë themele të forta për fuqizimin e institucionit të Urdhrit të Psikologut dhe si rrjedhojë po ndërtojmë dita-ditës themele të forta për përmirësimin dhe fuqizimin e rolit të psikologut në shoqëri.

Për mua është nder dhe privilegj të jemi së bashku në këtë rrugëtim!

Valbona Treska

Presidente

Tiranë, Shqipëri, Janar 2019



1. RRUGËTIMI I INSTITUCIONIT GJATË VITIT 2018

Viti 2018 ishte viti i parë i plotë, gjatë të cilit Urdhri i Psikologut ushtroi aktivitetin e tij pas vitit të parë të krijimit. Ka qenë një vit i vrrullshëm, me 600 karta licencimesh e praktikash profesionale të dhëna për psikologët, me një korrespondencë gati të përditshme me ministrinë e drejtësisë për rregullimin e statusit të psikologëve ligjorë, me shtysën çdo ditë për ministrinë e shëndetësisë dhe ministrinë e arsimit për të miratuar rregulloren e praktikës profesionale, si dhe me aplikimin në federatën europine të psikologjisë.

Në fund të janarit 2018 u nënshkrua nga të dy ministritë e linjës rregullorja e praktikës, e cila me bisedime të vazhdueshme dy palëshe parashikoi lejimin e realizimit të praktikës profesionale edhe në institucione jopublike, përvec atyre publike. Aktualisht, çdo psikolog lejohet të kryejë praktikën profesionale pranë një subjekti privat nën supervizionin e një psikologu me mbi 3 vjet eksperiencë pune në profesion.

Pak kohë më vonë, u nënshkrua së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale marrëveshja e bashkëpunimit, në njërën prej pikave të së cilës u dakordësua që ata psikologë të cilët vertëtonin se kishin kryer një vit punë si psikologë, pas diplomimit nga maji 2016 deri 30 janar 2018, mund të

përfshiheshin nga detyrimi për kryerjen e praktikës profesionale e t'i nënshtroheshin menjëherë provimit të shtetit. Aktualisht është ngritur Komisioni i Praktikës Profesionale, që do të shqyrtojë dosjet e praktikantëve të cilët do të kalojnë në provim shteti dhe ndërkohë po punohet me intensitet të plotë prej disa kohësh për fillimin e procedurave për realizimin e provimit të shtetit.

Në shkurt 2018, u zyrtarizuan në Lisbonë të Portugalisë marrëdhëniet me “Ordem dos Psicólogos Portugueses” dhe u zhvillua një takim zyrtar me figurën më të lartë europiane në psikologji, Z.Telmo Mourinho Baptista, presidenti i EFPA “European Federation of Psychologists’ Associations”. Në takimet e zhvilluara u arrit mbështetja e plotë e Presidentit për të përkrahur Urdhrin e Psikologëve të Republikës së Shqipërisë, si vend kandidat për anëtarësim me të drejta të plota në EFPA në kongresin e vitit 2019.

Në mars 2018, Urdhri i Psikologut nisi mbledhjen e dokumentacionit të të gjithë psikologëve që dëshironin të ishin pjesë e sistemit të drejtësisë, në bazë të kriterëve të parashikuar në ligj si dhe organizimi i trajnimit të psikologëve si detyrim ligjor i parashikuar nga ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”, i cili i ngarkon detyrën të gjithë urdhrave apo dhomave të



profesionistëve në vend të realizojnë trajnimet e posaçme për anëtarët e tyre.

Bazuar në këtë ligj, me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë u realizua hartmi i moduleve për trajnimin e posaçëm të psikologëve. Çdo informacion lidhur me procedurat, dokumentacionin apo data të fillimit të trajnimeve, është publikuar në faqen zyrtare të Urdhrit.

Në prill 2018, për t'i ardhur në ndihmë anëtarësisë në rrethet më të largëta, u bë e mundur ngritja e zyrave të Koordinatorëve Lokalë. Ngritja e këtyre zyrave erdhi si nevojë për të lehtësuar psikologët lidhur me dorëzimin e dokumentacionit, marrjen e informacionit, tërheqjen e kartave të anëtarësisë, e të tjera shërbime, pranë zyrës qendrore në Tiranë. Zyrat e Koordinatorëve u ngritën fillimisht në Shkodër, Lezhë e Korçë, ndërkohë që u vijua gjatë gjithë vitit me identifikimin e psikologëve të tjerë që do të shërbenin si koordinatorë lokalë në qytetet e tyre. Koordinatorët lokalë kanë vënë në dispozicion të urdhrit, pa asnjë detyrim financiar, plotësisht vullnetarisht, zyrat e tyre, numrat e telefonit, infrastrukturën e nevojshme, në mënyrë që shërbimet të kryen pranë tyre në rrethe.

Në prill 2018 u vendosën marrëdhëniet me UNICEF-in dhe u nis rruga e bashkëpunimit institucional. Një ndër institucionet ndërkombëtare më prestigjioze ka treguar gjatë vitit 2018 gatishmërinë dhe vendosmërinë për të përkrahur nismat e urdhrit të psikologut dhe për të na mbështetur në punën tonë të përditëshme.

Në fillim të majit nisi puna për ndërtimin e Regjistrat Elektronik të psikologëve, një platformë e cila kërkoi muaj pune dhe që pasqyron të dhënat profesionale të çdo psikologu, nga përfundimi i studimeve, deri në rilicencim.

Në maj 2018, pas një korrespondence disa mujore, Urdhri i Psikologut mori pjesë në takimin e shoqatave të psikologjisë europiane organizacionale në Torino të Italisë "European Association of Work and Organizational Psychology" EAWOP, si anëtar vëzhgues, kandidat për të fituar statusin e anëtarësisë me të drejta të plota në maj 2019.

Në maj 2018, pas një pune maratonë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, universitetet publike e jopublike në vend, Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, programin suedez SIDA dhe OJF të shoqërisë civile, startoi trajnimi i posaçëm (130 orë) për psikologët asistues dhe vlerësues të sistemit të drejtësisë, i cili zgjati për gati 2 muaj e gjysëm, cdo fundjavë. Për shkak të nevojave të sistemit, ky program trajnimi u ripërsërit për grupin e dytë të psikologëve të cilit plotësonin kriteret, në tetor 2018 dhe përfundoi në dhjetor 2018.

Më ndryshimet e reja të Kodit të Procedurës Civile si dhe hyrjen në fuqi të Kodit Penal për të Mitur, Urdhrit të psikologut i lindi detyrimi i realizimit të trajnimeve për psikologë të cilët do të përfshiheshin në sistemin e drejtësisë në rolin e asistuesit dhe të vlerësuesit. Në këto kushte, u bë e mundur realizimi i dy cikleve trajnimesh me 104



psikologë nga e gjithë Shqipëria. Këto trajnime u bënë të mundura me mbështetjen e vazhdueshme dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë, Programit suedez SIDA, mbështetjen e universiteteve publike dhe jobublike, Bashkinë Tiranë, Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Tiranë si dhe një sërë aktorësh të tjerë të cilët na përkrahën dhe ndihmuan në realizimin me sukses të këtij procesi. Sot, falë angazhimit maksimal të të gjithë insitucioneve kemi 104 psikologë specifikisht të trajnuar për të qenë pjesë e sistemit të drejtësisë emrat e të cilëve u janë vënë në dispozicion të gjithë rajoneve të policisë, prokurorive dhe gjykatave në të gjithë vendin. Për herë të parë, që nga viti 2003, kohë në të cilën figura e psikologut nisi të ishte pjesë e sisutemit të drejtësisë, kemi një grup të kualifikuar psikologësh në këtë fushë.

Urdhri i Psikologut ka hedhur gjatë këtij viti themelet e sistemit të Edukimit në Vazhdim. Asambleja Kombëtare e mbledhur më 27.07.2018 miratoi

ndryshimet në Statut lidhur me ngritjen e këtij sistemi si dhe me ngritjen e një komisioni prej 5 anëtarësh, i cili do të merret specifikisht me akreditimin e aktiviteteve me synim përfitimin e krediteve për rilicencimin e psikologëve në një shtrirje kohore prej 5 vitesh.

Në periudhën nëntor-dhjetor 2018 janë ndërmarrë, së bashku me koordinatorët në rrethe, një seri takimesh me përfaqësues të institucioneve, me qëllim fuqizimin e rolit të psikologut si dhe vlerësimin e hapsirave për hapjen e pozicioneve të reja të punës për psikologët.


Gjatë vitit 2018, Urdhri i Psikologut ka qenë pjesë aktive e çdo tryeze të rrumbullakët në të cilat është ngritur çdo shqetësim i psikologëve, duke qenë pjesë aktive për të vendosur në rrugën e duhur psikologët shkollorë, organizacionalë, të shëndetësisë e të cdo profili tjetër të psikologëve si dhe pjesë aktive e çdo aktiviteti të ndërmarrë nga ministrinë e linjës.

2. Struktura e Urdhrit të Psikologut

Organet kryesore të Urdhrit janë:

- a) Asambleja Kombëtare;
- b) Këshilli Kombëtar;
- c) Presidenti i Urdhrit;
- ç) Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional
- d) Komisioni i Edukimit në Vazhdim
- e) Komisione të tjera, ku përfshihen aktualisht Komisioni i Licencimit dhe Komisioni i Praktikave Profesionale.

Organigrama e Urdhrit të Psikologut



2.1 Asambleja Kombëtare

Organi më i lartë drejtues i Urdhrit të Psikologut, bazuar në ligjin nr.40/2016, është Asambleja Kombëtare. Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut.

Asambleja Kombëtare ka këto funksione:

a) zgjedh Këshillin Kombëtar dhe Presidentin e Urdhrit, me votim të

fshehtë dhe me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të saj;



b) miraton statutin e Urdhrit;



c) miraton Kodin e Etikës dhe Deontologjisë;



d) miraton rregulloren për gjykimin disiplinor profesional;
e) miraton rregulloren për regjistrimin, anëtarësimin dhe licencimin;
f) miraton rregulloren për organizimin e praktikës profesionale;
g) shqyrton dhe miraton projekt-buxhetin e Urdhrit, si dhe shqyrton buxhetin faktik të tij;
h) analizon veprimtarinë vjetore të organeve të Urdhrit;
i) shqyrton raportin e auditit të jashtëm, në intervale trevjeçare.

2.2 Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar i Urdhrit është organi ekzekutiv i Urdhrit, i cili përbëhet nga 17 anëtarë.

Anëtarë të zgjedhur të Këshillit Kombëtar janë:

Dr. Blerta Bodinaku
Dr. Fleura Shkëmbi
(zgjedhur me mandat zëvendësues në Asamblenë II Kombëtare)
Dr. Brunilda Laboviti
Dr. Valbona Habili
Elona Mustafaraj
Dr. Skerdi Zahaj
Rezarta Basha
Gracela Mana
Sonila Meçaj
Denada Toçe
Redina Balla

Në përbërje të Këshillit Kombëtar janë edhe 4 anëtarë të caktuar nga Ministritë, përkatësisht nga:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (njëkohësisht edhe Autoriteti

Kompetent i Urdhrit të Psikologut sipas ligjit):

Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
Ministria e Drejtësisë
Ministria e Mbrojtjes



Këshilli Kombëtar ka këto përgjegjësi:

a) miraton strukturën e vet organizative;
b) cakton kuotizacionin dhe tarifat;
c) administron pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të Urdhrit në nivel kombëtar;



ç) mbikëqyr të gjithë veprimtarinë e organeve që varen prej tij;
d) harton statutin, rregulloret e Urdhrit, si dhe Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe ia propozon ato për miratim Asamblesë Kombëtare;

dh) mban dhe përditëson Regjistrin e Urdhrit të Psikologut;
e) ngre grupe pune ad hoc për kryerjen e kontrolleve për ushtrimin e profesionit të psikologut;
ë) përgatit dhe publikon raportin vjetor dhe financiar.

2.3 Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional.

Ky komision është ngritur pranë Urdhrit të Psikologut në zbatim të nenit 19 të Ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut”. Ky komision, bazuar në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional, miratuar me nr.16 , datë 18.05.2017, me vendim të Këshillit Kombëtar, ka një mandat 3 vjeçar.

Komisioni i Gjykimit Disiplinor ka në strukturën e tij 5 anëtarë me një eksperiencë pune mbi 10-vjeçare në profesion:
Dr.Edvin Lame

Dr.Jonida Haxhiu
Dr.Migena Buka
Dr.Stela Dhima
Dr.Lediana Xhakollari *(zgjedhur me mandat zëvendësues me vendim nr. Nr.7, dt.02.10.2018.. të Këshillit Kombëtar.*

Komisioni funksionon në bazë të Ligjit për Urdhrin e Psikologut, Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, si dhe Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional.

2.4 Administrata e Urdhrit të Psikologut

Administrata përbëhet nga:


Zyra Juridike – një punonjës, Z.Igli Çutra

Zyra e Financës – një punonjës, Z.Lejdi Goga

Sekretariati, protokolli, arshiva – një punonjëse, Znj.Armira Baboçi



Igli ÇUTRA



Armira BABOÇI



Lejdi GOGA



2.5 Komisione të tjera

Pranë Urdhrit të Psikologut funksionojnë disa komisione të tjera, të cilat janë të domosdoshme për realizimin e misionit të tij.

2.5.1 Komisioni i Licencimit

I ngritur me vendimin nr. 13 dt. 29.03.2017 nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut, i ndryshuar me vendim nr.17 dt.16.06.2017, (po nga ky Këshill), Komisioni i Licencimit ka në strukturën e tij 5 anëtarë, nga të cilët:

Presidenti - Dr.Valbona Treska

1 anëtar nga Zyra Juridike - Z.Igli Çutra

3 anëtarë nga Këshilli Kombëtar:

Dr.Skerdi Zahaj

Sonila Meçaj

Gracela Mana



Gjatë vitit 2018, ky komision ka licencuar 185 psikologë të rinj, të ndarë sipas fushave të mëposhtëme, disa prej të cilëve kanë dy profile studimi:

Psikologë klinikë - 97 anëtarë

Psikologë këshillimi - 25 anëtarë

Psikologë shkollor -13 anëtarë

Psikologë organizacionalë - 12 anëtarë

Psikologë në orientim profesional - 3 anëtarë

Psikologë në institucione - 6 anëtarë

Psikologë ligjorë - 2 anëtarë

Psikologë biznesi - 1 anëtar

Psikologë në kërkim në psikologji - 2 anëtarë

Psikologë të përgjithshëm - 5 anëtarë

Psikologe Shkollorë dhe Organizimi - 19 anëtarë

2.5.2 Komisioni i Praktikës Profesionale

Në zbatim të ligjit “Për profesionet e rregulluara”, të gjithë psikologët që kanë përfunduar studimet para vitit 2016 apo pas vitit 2016¹, por që nuk provojnë se kanë patur eksperiencë pune të mëparshme, duhet t’i nënshtrohen kryerjes së Praktikës Profesionale dhe Provimit të Shtetit². Në bashkëpunim

me Ministrinë e Shëndetësisë, u miratua Rregullorja e Praktikës Profesionale e cila mundësoi rregullimin

të një profesioni të rregulluar, çdo kandidat duhet: a) të kryejë praktikën profesionale; b) të kryejë provimin e shtetit; c) të regjistrohet në UP-në përkatëse.Neni 11 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), pika 3.: “.....Modalitetet e organizimit të vlerësimit të aftësimit praktik përcaktohen në rregulloren e praktikës profesionale, që miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës”.

¹ Memorandumi i bashkëpunimit mes UP dhe MSHMS

² Neni 8 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), pika 1.: Për të fituar të drejtën e ushtrimit



ligjor të vijimit të procedurave për një numër të konsiderueshëm psikologësh të sapodiplomuar dhe përjashtimin nga kjo praktikë për një kategori tjetër.

Komisioni i Praktikës Profesionale drejtohet nga Presidenti i Urdhrit dhe përbëhet nga anëtarët e zgjedhur nga Këshilli Kombëtar, konkretisht: Dr.Brunilda Laboviti, Znj.Redina Balla, Znj.Aleksandra Puçi, si dhe nga juristi i Urdhrit të Psikologut, Z.Igli Çutra.

Këtë vit janë regjistruar rreth 50 praktikantë, me kontrata të rregullta

punësimi dhe supervizimi, sipas fushave:

Psikologë klinikë - 18 praktikantë
Psikologë shkollorë - 16 praktikantë
Psikologë organizacionalë - 2 praktikantë
Psikologë këshillimi - 4 praktikantë
Psikologë të përgjithshëm - 2 praktikantë
Psikologë në institucione - 6 praktikantë
Psikologë në orientim profesional - 2 praktikantë

2.5.3 Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji

Me ndryshimet që u bënë në ligjin nr.10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, në vitin 2014, profesioni i psikologut u përfshi në listën e profesioneve të rregullara. Qëllimi i përfshirjes së këtij profesioni në këtë listë ishte rregullimi me ligj i kriterëve dhe standardeve për mënyrën e ushtrimit të profesionit. Konkretisht, ky ligj përcakton se: *Profesionisti ka detyrim të kujdeset për përditësimin e aftësive të veta profesionale (Neni 16/c).*

Me qëllim zbatimin me efektivitet të këtij ligji, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2016 Ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në RSH”. Referuar Relacionit që shoqëron miratimin e këtij akti, rezulton se: *“Qëllimi kryesor i këtij ligji është rregullimi i marrëdhënieve të profesionistëve kundrejt shtetit dhe mbrojtjes së publikut nga ofrimi i shërbimit nga persona të pakualifikuar*

dhe nga sjellja joprofesionale e personave të specializuar për të ofruar shërbime të tilla.

Ky ligj bën të mundur delegimin e kompetencave për dhënien e së drejtës së ushtrimit të profesionit të psikologut tek një trup profesionistësh me kontribut të theksuar në fushën e psikologjisë (Urdhri i Psikologut) dhe përmirësimin e edukimit të vazhdueshëm në ngritjen profesionale të psikologut.”

Në lidhje me ngritjen e një sistemi të normuar të edukimit në vazhdim në fushën e psikologjisë, konkretisht, ky ligj përcakton në nenin 6 se:

1. *Misioni i Urdhrit të Psikologut është nxitja dhe ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesionit në fushën e psikologjisë, si dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit të psikologut.*
2. *Për realizimin e misionit të tij, Urdhri i Psikologut ushtron këto kompetenca:*



...c) nxit arritjen e standardeve të larta në edukimin dhe formimin profesional e etik të anëtarëve të Urdhrit;

e) bashkëpunon me institucionet përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi, institucionet e tjera, shkencore dhe arsimore, për të siguruar standarde në edukimin e vazhdueshëm, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të Urdhrit;

Po aty, në nenin 9, përcaktohet :
Anëtari i Urdhrit të Psikologut ka të drejtë:

a) të kërkojë krijimin e kushteve të favorshme për ushtrimin normal të profesionit, për edukimin e vazhdueshëm dhe për përparimin e karrierës;

b) të punojë për rritjen e standardeve profesionale e të cilësisë së shërbimit në fushën e psikologjisë në institucionin ku punon dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e edukimit të vazhdueshëm;

Nisur nga sa më sipër, ngritja e sistemit të edukimit në vazhdim në profesionin e rregulluar të psikologut ishte një detyrim ligjor i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë si i vetmi organ kompetent ligjor për :

- garantimin e kriterëve për lejin e ushtrimit të profesionit të psikologut, nëpërmjet procedurës së licencimit
- garantimin e mbikqyrjes së mënyrës së ushtrimit të profesionit dhe mbrojtja e përfituesve të shërbimit nga kequshtrimi i profesionit, nëpërmjet Komisionit të Etikës Profesionale dhe të Gjyqimit Disiplinor
- garantimin e ruajtjes dhe rritjes së standardeve profesionale nëpërmjet

sistemit të edukimit në vazhdim, në kuadër të rilicencimit.

Edukimi në vazhdim nënkupton procesin nëpërmjet të cilit psikologët përditësojnë dijet dhe aftësitë e tyre në fushën e psikologjisë, për të ruajtur kompetencën profesionale. Të gjithë profesionet e rregulluara kanë si një nga elementet bazë të tyre sistemin e edukimit në vazhdim dhe të gjithë kanë një mekanizëm autonom për garantimin e vlefshmërisë së këtij procesi.

Ligji për Urdhrin e Psikologut përcakton se:

- ky institucion është i vetmi organizëm profesional që garanton ruajtjen e standardeve gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të profesionit të psikologut, (neni 6, pika 1, e ligjit 40/2016)
- ky institucion është i vetmi organizëm autonom profesional që jep dhe heq të drejtën e ushtrimit të profesionit, (neni 6, pika 2, gërma.a., e ligjit 40/2016)
- ky institucion është i vetmi organizëm autonom profesional që në bashkëpunim edhe me institucione të tjera, siguron standardet në edukimin e vazhdueshëm, kualifikimet dhe specializimet pasuniversitare të anëtarëve të tij;

Bazuar në sa më sipër, ishte detyrë ligjore e Urdhrit të Psikologut ndërtimi dhe administrimi i një sistemi efektiv për edukimin në vazhdim për psikologët.

Parimi bazë i sistemit të edukimit në vazhdim në fushën e psikologjisë, i



përcaktuar në piken 1 të kësaj rregulloreje është se :

« 1.1 Psikologu e planifikon vetë pjesëmarrjen në aktivitete të edukimit në vazhdim, bazuar në nevojat e tij profesionale, nevojat e identifikuar nga institucioni ku ushtron aktivitetin dhe kompetencat e dëshiruara..

1.2 Psikologu zgjedh ato aktivitete që bazohen në nevojat e perceptuara nga ai vetë, si dhe në ato që janë identifikuar nga vlerësime të tjera. ».

Në çdo rast është vetë psikologu që zgjedh sistemin e kualifikimit të vet profesional.

Asambleja e Përgjithshme bëri ndryshimet e nevojshme në Statut për ngritjen e sistemit të Edukimit në Vazhdim dhe i hapi rrugën ngritjes së Komisionit të Edukimit në Vazhdim në Psikologji, duke përcaktuar kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të këtij Komisioni, si dhe duke i deleguar Këshillit Kombëtar të drejtën për të miratuar Rregulloren e Edukimit në Vazhdim në Psikologji.

Konkretisht, në mbledhjen e datës 22.06.2018 me vendimin nr.5, Këshilli Kombëtar miratoi ndryshimet në Statut, lidhur me edukimin në vazhdim dhe ia propozoi për miratim Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut. Në datë 27.07.2018, në Asamblenë e II-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut, u miratuan me shumicë votash ndryshimet në Statut dhe ngritja e strukturës së edukimit në vazhdim e përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, si dhe u miratua mënyra e organizimit të Edukimit në Vazhdim.

Pas hartimit të Rregullores nga grupi i punës, kjo rregullore Ju propozua për miratim Këshillit Kombëtar, në mbledhjen e datës 21.11.2018. Pasi u rishikua Rregullorja nga anëtarët e Këshillit Kombëtar, në mbledhjet e datës 21.11.2018 dhe në vazhdimin e saj, datë 04.12.2018 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut, bazuar në nenin 6, pika 2/e), të Ligjit Nr.40/2016 "Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë", si dhe në nenet 21, 40.1-40.7 të Statutit të Urdhrit të Psikologut, u ngrit me 9 (nëntë) vota pro, 1 (një) Komisioni i Edukimit në Vazhdim dhe u miratua Rregullorja e Edukimit në Vazhdim i Rregullores së Edukimit në Vazhdim është rritja e vazhdueshme e njohurive dhe zhvillimi i aftësive profesionale të psikologëve, në funksion të përmirësimit të shërbimit psikologjisë në vend.

Komisioni i Edukimit në Vazhdim në Psikologji (KEVP) është organ i Urdhrit të Psikologut përgjegjës për:

- planifikimin, bashkërendimin dhe zbatimin e programeve të formimit të vazhdueshëm të psikologëve;
- bashkërendimin e punës dhe realizimin e procesit të akreditimit të programeve dhe veprimtarive të edukimit në vazhdim në psikologji;
- mbarëvajtjen e procesit të rilicencimit të psikologëve;
- realizimin e studimeve të vlerësimit të nevojave për formim të vazhdueshëm për të gjithë specialitetet e psikologjisë, në përgjithësi;
- hartimin dhe/ose miratimin e programeve të aktiviteteve të edukimit profesional fillestar ose vazhduesh, kur



nga aktet ligjore e nënligjore, kërkohet që këto aktivitete të kryhen drejtpërdrejt nga Urdhri i Psikologut.

Ky Komision drejtohet nga Presidenti i Urdhrit të Psikologut dhe ka në përbërje anëtarët e mëposhtëm të

zgjedhur me vendim të Këshillit Kombëtar:

Prof.Dr.Theodhori Karaj,
Prof.As.Dr.Zenel Orhani,
Prof.As.Dr.Erika Mellonashi
Dr.Marsela Shehu.

2.5.4 Koordinatorët Lokal

Urdhri i Psikologut, për t'u ardhur në ndihmë e për të lehtësuar shërbimet për anëtarët e tij në rrethet e largëta, ndërmori ngritjen e rrjetit të Koordinatorëve Lokal në mbarë vendin, rrjet i cili synon t'i paraprijë hapjes së Zyrave Rajonale të Urdhrit të Psikologut.



Ky rrjet ka si qëllim ofrimin e mbështetjes, ndihmës dhe mbrojtjes së interesave për të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut të rajonit përkatës, duke patur në fokus nevojat dhe problematikat, që ata ndeshin gjatë ushtrimit të profesionit të psikologut.

Koordinatori lokal ka si mision:

- kryerjen e shërbimeve për anëtarët e Urdhrit, në kuadër të shpërndarjes efektive të informacioneve që lidhen me

ushtrimin e profesionit, mbledhjes dhe shpërndarjes së dokumentacionit specific, me qëllim përmirësimin e cilësisë së ushtrimit të profesionit të psikologut në institucionet përkatëse rajonale dhe uljen e kostove për përfitimin e këtyre shërbimeve për anëtarët e Urdhrit në rajon

- vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve të Urdhrit e organet vendore dhe subjektet e tjera publike dhe privatë në rajon, me qëllim rritjen e ndikimit dhe faktorizimin e Urdhrit të Psikologut në rajon.



Disa nga funksionet që do të kryejnë Koordinatorët Lokalë janë:

- Dhënia e informacionit të detajuar për çdo psikolog, i cili do të kryejë procedurat e anëtarësimit, licencimit, zhvillimit të praktikës profesionale,



provimit të shtetit, kryerjen e trajnimeve të ndryshme, etj.

- Mbledhja e të gjitha dokumentave të nevojshme të psikologëve të rajonit përkatës përsa i përket procedurës së anëtarësimit, si dhe të çdo dokumenti tjetër që lidhet me Urdhrit, dhe përcjellja e tyre pranë Urdhrit të Psikologut.

- Shpërndarja për psikologët e rajonit përkatës të lejes së ushtrimit individual të profesionit (Licencave Profesionale) apo e çdo dokumentacioni tjetër të lëshuar nga Urdhri për anëtarët e këtij rajoni.

- Krijimi dhe ruajtja e marrëdhënieve të bashkëpunimit, brenda rajonit, me institucionet e administratës shtetërore, organizma jo-qeveritare, si dhe me çdo subjekt tjetër publik apo privat, që ka qëllime të përbashkëta me Urdhrit të Psikologut.

- Informimi i psikologëve të rajonit lidhur me vendimet dhe udhëzimet e Urdhrit të Psikologut, si dhe për aktet normative, misionin, synimin dhe funksionet e Urdhrit të Psikologut.

- Mbështetja për organizimin dhe zhvillimin e veprimtarive studimore e shkencore në fushën e psikologjisë në rajon.

Gjithashtu, Koordinatorët Lokalë pranojnë çdo ankesë të ardhur nga cilido person fizik apo juridik në drejtim të psikologëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin shoqërues, dhe e dërgojnë atë pranë Zyrës Qendrore të Urdhrit të Psikologut, me qëllim iniciimin e procedurave të shqyrtimit nga Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional.



Koordinatorët Lokal të Urdhrit të Psikologut të promovuar gjatë vitit 2018 janë:

➤ **Koordinatori Lokal për Rajonin e Shkodrës**

Qendra e Këshillimit dhe Shërbimeve Psikologjike, me Drejtor Ekzekutiv,
Z. Altin Nika

Adresa: Rruga Hysej, Dugajet e Reja,
ish-godina e shkollës "Zani Shkodrës"
Tel.: 0684420000
e-mail: altinnika@yahoo.com

➤ **Koordinatori Lokal për Rajonin e Lezhës:**

Z. Besmir Frroku

Adresa: Blv. "Gjergj Fishta", Godina Nr.4,
Kati 2, Lezhë
Tel.: 0693930434
e-mail: besmir.frroku@hotmail.com

➤ **Koordinatori Lokal për Rajonin e Korçës:**

Z. Andi Petro

Adresa: Qendra e Shëndetit Mendor, Korçë
Tel.: 0695303133
e-mail: andipetro.al@gmail.com



3. Aktiviteti i organeve drejtuese dhe aktet normative të nxjerra gjatë këtij viti

3.1 Këshilli Kombëtar

Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë, përgjatë këtij viti, ka patur një aktivitet shumë të ngjeshur.

Gjatë vitit 2018 janë marrë vendimet e mëposhtme:

- Vendim Nr.1, dt.26.01.2018, “Miratimi i Raportit Vjetor 2017”
- Vendim Nr.2, dt.05.02.2018 “Miratimi i Buxhetit Faktik 2017”
- Vendim Nr.3, dt.04.06.2018, “Miratimi i Projekt Buxhetit të vitit 2018, të propozuar nga administrata e Urdhrit me kuotizacion të pandryshuar”
- Vendim Nr.4, dt.04.06.2018, “Ngritja e Komisionit të Praktikës Profesionale dhe përcaktimi i honorarit”
- Vendim Nr.5, dt.22.06.2018, “Miratimi i ndryshimeve në Statutin e Urdhrit të Psikologut”
- Vendim Nr.6, dt.22.06.2018, “Miratimi i ndryshimeve në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional”

- Vendim Nr.7, dt.02.10.2018, “Zgjedhja e Znj.Lediana Xhakollari, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor, në vendin vakant të krijuar pas dorëheqjes së Znj.Anjeza Vila”.
- Vendim Nr.8, dt.02.10.2018, “Për përlllogaritjen e punës part-time me koefiçent 0.5 për çdo vit eksperience”.
- Vendim Nr.9, dt.21.11.2018, “Për ngritjen e Komisionit të Edukimit në Vazhdim.”
- Vendim Nr.10, dt.04.12.2018, “Për miratimin e Rregullores së Edukimit në Vazhdim”.
- Vendim Nr.11, dt.19.12.2018 “Për miratimin në vlerë të pandryshuar prej 6.000 lekë, kuotizacionin vjetor për vitin 2019”.
- Vendim Nr.12, dt.21.12.2018, “Për miratimin e Projekt-buxhetit për vitin financiar 2019”.

3.2 Asambleja Kombëtare

Këtë vit, më 27.07.2018, në mjediset e “Dajti Park Resort”, Tiranë u

organizua Asambleja e 2-të Kombëtare e Urdhrit të Psikologut.



Asambleja Kombëtare u zhvillua me këtë rend dite:

- 1) Miratimi i ndryshimeve në Statutin e Urdhrit të Psikologut dhe Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut.
- 2) Miratimi i buxhetit faktik të vitit 2017 dhe projekt-buxhetit të vitit 2018, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut.
- 3) Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Kombëtar, për plotësimin e vendit vakant.



Asambleja u zhvillua në mes të diskutimeve dhe debateve konstruktive

dhe miratoi të gjithë pikat e rendit të ditës.

Asambleja II Kombëtare mori vendim:

1. Të miratojë me 106 vota pro dhe 4 vota kundër, të anëtarëve të pranishëm, ndryshimet në Statutin e Urdhrit të Psikologut.
2. Të miratojë me 109 vota pro dhe 1 kundër, të anëtarëve të pranishëm, ndryshimet në Rregulloren e Gjykimit Disiplinor Profesional të Urdhrit të Psikologut.
3. Të miratojë Buxhetin Faktik të vitit 2017 me 101 vota pro dhe 9 kundër të anëtarëve të pranishëm.
4. Të miratojë Projekt- Buxhetin e vitit 2018 me 99 vota pro dhe 11 kundër të anëtarëve të pranishëm.
5. Të zgjedhë Znj.Fleura Shkëmbi si anëtare të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut me 75 vota pro, 14 kundër dhe 16 vota të pavlefshme.

3.3 Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Disiplinor Profesional

Komisioni gjykon në bazë të “Ligjit 40/2016 për Urdhrin e Psikologut”, “Statutit”, “Kodit të Etikës dhe Deontologjisë” dhe “Rregullores së Gjykimit Disiplinor Profesional”.

Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional ka shqyrtuar gjatë këtij viti disa ankesa, të iniciuara nga individë të ndryshëm ose edhe kryesisht nga Presidentja e Urdhrit, për raste sensitive dhe që kanë tërhequr vëmendjen e opinionit publik.

Gjatë këtij viti, duke u bazuar edhe në respektimin e afateve dhe procedurave të caktuara në aktet normative, Komisioni ka shqyrtuar në bazë të ankesës së qytetarëve 5 çështje kundrejt psikologëve, ndaj të cilëve është drejtuar ankesa.

Vendimet e dhëna nga komisioni:

- 3 raste rrëzim i ankesës
- 2 raste marrje mase disiplinore ndaj psikologut



4. Anëtarësia e Urdhrit të Psikologut

Për të qenë anëtar i Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë, psikologët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- të kenë diplomën e studimeve të larta “Bachelor” dhe “Master shkencor” ose “Master profesional” në psikologji ose ekuivalent me të, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë, lëshuar nga institucioni i arsimit të lartë, brenda apo jashtë vendit, të njohura nga ministria përgjegjëse për arsimin;

- të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me

ushtrimin e profesionit, në momentin e kërkesës për anëtarësim.

Anëtarësia ka patur një rritje gjatë vitit 2018, por ende nuk është në nivelet e pritura. Administrata e Urdhrit në vazhdimësi ka bërë një punë të madhe sensibilizuese jo vetëm karshi vetë psikologëve, por edhe në institucionet publike e private, të cilat janë ndërgjegjësuar për nevojën e zbatimit të ligjit.

Në total Urdhri i Psikologut ka arritur deri më sot rreth 757 anëtarë të regjistruar, nga të cilët 161 psikologë të regjistruar në vitin 2018.

4.1 Psikologë të licencuar

Licencimi i psikologëve rregullohet në bazë të Ligjit “Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë”. Sipas këtij ligji, pas përmbylljes së studimeve Bachelor dhe Master në psikologji, duhet të kryhet praktika një vjeçare profesionale dhe më pas të jepet provimi i shtetit, si parakusht për licencimin.

Përfundimisht, në këtë ligj parashikohet se psikologët, të cilët e kanë ushtruar profesionin përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përjashtohen nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit. Në këto kushte, në përmbushje të detyrimeve ligjore, Urdhri inicioi

procesin e licencimit për këtë kategori të psikologëve, bazuar në Ligjin Nr.10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në R.Sh” (i ndryshuar)³ dhe Memorandumin e Bashkëpunimit mes ish-Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Urdhrit të Psikologut.

³Neni 9 i Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), pika 4.:Përjashtohet nga detyrimi për të dhënë provimin e shtetit: a) profesionisti që, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ushtron ose ka ushtruar një profesion të rregulluar;



Aktualisht, licencimi i psikologëve sipas fushës së kompetencës, paraqitet si më poshtë:

Psikologë të Licencuar	Viti 2017	Viti 2018	Total
Total të Licencuar	307	175	482
Psikologë Klinikë	147	97	244
Psikologë Shkollorë& Organizacionalë	48	19	67
Psikologë Shkollorë	28	14	42
Psikologë Organizacionalë	8	13	21
Psikologë në Institucione	17	6	23
Psikologë në Këshillim Psikologjik	41	25	66
Psikologë në Kërkim Psikologjik	5	2	7
Psikologë në Orientim Profesional	9	3	12
Psikologë Ligjorë	5	2	7
Psikologë të Përgjithshëm	8	2	10
Psikologë Komuniteti	2		2
Psikologë në Rehabilitim Psikologjik	1	-	1

5. NDËRTIMI I REGJISTRIT ELEKTRONIK ONLINE

Në fillim të muajit maj nisi puna për ndërtimin e regjistrit elektronik online të psikologëve, një platformë e cila kërkoj muaj pune dhe që pasqyron të dhënat profesionale të çdo psikologu, nga përfundimi i studimeve, deri në rilicencim.

Ky regjistër përmban listën e psikologëve të anëtarësuar në Urdhër.





Aty gjenden të dhënat identifikuese për secilin psikolog. Regjistri është ndërtuar të funksionojë në dy sisteme. Në sistemin elektronik përfshihet çdo e dhënë për psikologët anëtarë, ndërkohë që online publikohen e janë të dukshme vetëm të dhëna të domosdoshme për psikologët, të cilat mund të aksesohen nga vetë ata apo të interesuarve.

Regjistri online i publikuar është i ndarë në këto rubrika: numri

identifikues për çdo të anëtarësuar, emri/mbiemri, vendbanimi dhe numri i kontaktit ose në mungesë adresa e postës elektronike. Vendbanimi është një e dhënë e domosdoshme në mënyrë që të interesuarit të identifikojnë psikologët që ushtrojnë profesionin pranë vendbanimeve të tyre për të marrë shërbim më të shpejtë kur u nevojitet.

6. TRAJNIMET PËR PSIKOLOGËT NË FUSHËN E DREJTËSISË

Në kuadër të hyrjes në fuqi të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe ndryshimeve në Kodin e Procedurës Civile për pjesën e ekspertit, lindi nevoja për patur një shërbim në përputhje me këtë kuadër të ri ligjor dhe sa më profesional me psikologë të trajnuar posaçërisht në fushën e drejtësisë, në rolin e asistuesit dhe vlerësuesit, të cilët do të ofronin ekspertizën në fushën e drejtësisë në komisaritet e policisë, prokuroritë dhe gjykatat në të gjithë vendin.



Në këto kushte, për të garantuar funksionimin e këtyre ligjeve të reja dhe të sistemit të drejtësisë në përgjithësi, me shkresën nr.7173/11, dt.26.12.2017 të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në diskutimet e grupit ndërinstitucional të punës, të ngritur për këtë qëllim, Urdhrit të Psikologut iu kërkua të identifikojë të gjithë psikologët që janë të specializuar në drejtësinë për të mitur (bazuar në formimin e posaçëm apo eksperiencën e



punës), si dhe të hartonte programet e trajnimit dhe përditësimit të trajnimeve për këtë kategori psikologësh.



Realizimi i trajnimit për psikologët në fushën e drejtësisë, si një trajnim i realizuar për herë të parë në këtë fushë, ishte një sfidë për institucionin e Urdhrit e Psikologut, si në aspektin e organizimit të moduleve, zgjedhjes së psikologëve që do të përfshiheshin në të, ashtu edhe të infrastrukturës së nevojshme.



Për hartimin e moduleve të trajnimit u kërkuar bashkëpunim i universiteteve publike dhe private në vend si dhe i shoqatave të shoqërisë civile. Urdhri i Psikologut, në bashkëpunim me projektin suedez, universitetet publike dhe private në vend, organizata civile të specializuara në drejtësinë për të mitur,

si dhe me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ngriti grupin e lektorëve që përgatitën programet e trajnimit të ndara në dy module.

Një grup ekspertësh prej 5 vetash hartuan modulet e trajnimit me temat përkatëse. Njëri modul shërbeu për ata psikologë të cilët mund të thirren në cilësinë e asistuesit të të miturit në çdo fazë procedimi, ndërsa moduli i dytë shërbeu për psikologët, të cilët mund të thirreshin në cilësinë e ekspertit vlerësues.



Përmbajtja e moduleve u ndërtua në mënyrë të tillë që t'u shërbente psikologëve për përvetësimin dhe rritjen e njohurive profesionale në fushën e drejtësisë për të mitur, si në çështjet penale, ashtu dhe në ato civile, pasi pavarësisht nga fusha ku thirret psikologu, roli që kryen, qoftë si asistuesit, ashtu edhe si ekspert vlerësues, është i njëjtë. Trajnimi për psikologët asistues ishte gjithsej 50 orë, ndërsa për psikologët që ndoqën edhe modulin e II në cilësinë e ekspertit ishte 80 orë, pra një total prej 130 orë. Thirrja për trajnimin e parë të organizuar nga UP u bë nëpërmjet thirrjes publike. Psikologët që plotësuan kriteret nisën trajnimin më dt.11.05.2018.



Në dt.25.07.2018 Urdhri i Psikologut përfundoi trajnimin për grupin e parë të psikologëve në fushën e drejtësisë për të mitur, ku morën pjesë 54 psikologë, të cilët pas këtij trajnimi mund të thirren në rolin e asistuesit të të miturit. Ndër to 24 psikologë, të cilët iu nënshtruan të dy moduleve të trajnimit, kanë mundësi të thirren në rolin e ekspertit, në të gjitha fazat e hetimit dhe gjyqimit.



Në kuadër të nevojës për të patur një numër më të madh psikologësh të trajnuar, që do të mund të mbulojnë nevojat me shërbimet që ofrojnë si psikologë asistues dhe vlerësues në komisaritet e policisë, prokuroritë dhe gjykatat në të gjithë vendin, në dt.05.10.2018 Urdhri i Psikologut nisi

ciklin e trajnimeve për grupin e dytë të psikologëve, i cili përfundoi në dt.14.12.2018.



Në këtë trajnim të dytë morën pjesë 51 psikologë, nga të cilët 16 psikologë nga Tirana dhe 35 psikologë nga rrethet. Qëllimi i këtij trajnimi të dytë ishte shtimi i numrit të psikologëve të trajnuar sipas ligjit vecanërisht në rrethe, kjo për shkak të nevojës më të madhe të qyteteve të tjera të Shqipërisë për këtë shërbim.



Struktura e trajnimit, modulet dhe trajnuesit në këtë trajnim të dytë ishin të njëjtë si me trajnimin e parë. Në të dy modulet u konfirmua paraprakisht pjesëmarrja e ekspertëve suedezë si trajnues në disa tema trajnimi.



Në të dyja trajnimet kriteret e përzgjedhjes, ishin bazuar në kërkesat e psikologëve, anëtarë të Urdhrit të Psikologut, në të cilat shprehnin vullnetin për të qenë pjesëmarrës në trajnim, brenda afateve zyrtare të publikuara nga Urdhri i Psikologut në faqen zyrtare të tij, si dhe në bazë të eksperiencës së tyre në ushtrimin e profesionit të psikologut (në fushën e drejtësisë apo si psikologë në fusha të tjera).



Kjo eksperiencë e tyre u bazua në dokumentat provues të sjella nga vetë psikologët, për të bërë kështu të mundur klasifikimin e tyre nëse, i nënshtrohen të dyja moduleve apo vetëm njërit prej tyre, në mbështetje edhe të kriterëve ligjore të sanksionuara nga neni 224 d) i Kodit të Procedurës Civile.

Kështu, të gjithë ata psikologë, të cilët provuan se kishin patur eksperiencë më shumë se 5 (pesë) vite në fushën e

psikologjisë, u përfshin në të dyja modulet e trajnimit, pra për të qenë si në rolin e asistuesit të të miturit po ashtu edhe të vlerësuesit, ndërsa psikologët, të cilët kishin të provuar eksperiencë në fushën e psikologjisë më pak se 5 (pesë) vite, ju nënshtroan vetëm modulit të parë të trajnimit, për të qenë në rolin e asistuesit (mbështetësit emocional) për të miturin.



Duhet theksuar fakti se përgjatë periudhës së vendosur për marrjen e aplikimeve për përfshirjen në trajnim nga data 12.06.2018 deri në datë 10.07.2018, në Zyrën e Urdhrit të Psikologut, mbërriti një numër shumë i lartë kërkesash për aplikim.



Për mos cënuar standardin e trajnimit, për të patur një numër pjesëmarrësish që të mund të ndërvepronin mes tyre e me trajnuesit, që nuk kalonte përmasat e një trajnimi dhe nuk kthehej në një leksion rutinë, u përfshinë 51 psikologë, të cilët kishin dorëzuar kërkesat pranë UP.



Sikundër u theksua, 69% e pjesëmarrësve ishin nga rrethet e ndryshme të Shqipërisë.



Vlen të theksohet se për disa për pjesëmarrësit nga rrethet, ndonëse afati i plotësimit të dokumentacionit ishte deri më datë 10.07.2018, u vlerësua e nevojshme tejkalimi i këtij afati lidhur me dokumenta të caktuara për atë kohë sa nevoja e qyteteve të ndryshme të Shqipërisë për psikologë të trajnuar vazhdon të mbetet e lartë, ndërkohë që në këtë përzgjedhje të tyre edhe përtej afatit të aplikimit, u mbajtën në konsideratë ata psikologë të cilët e kishin këtë trajnim shumë të

rëndësishëm për shkak të pozicionit të punës.



Në lidhje me kostot financiare të këtyre trajnimeve, një pjesë e shpenzimeve të trajnimit u paguan nga vetë psikologët pjesëmarrës në trajnim, ndërsa një pjesë nga institucionet me të cilat Urdhri i Psikologut bëri të mundur realizimin e këtij trajnimi dhe Programit Suedezi. Trajnimi i parë u zhvillua në ambientet e Parkut Olimpik, i cili u ofrua pa pagesë nga Bashkia Tiranë, Drejtoria e Parqeve dhe Rekreacioneve, ndërsa trajnimi i dytë u zhvillua në ambientet e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, Tiranë, ambient i cili u ofrua pa pagesë nga ky fakultet në kuadër të marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit.



Të gjithë psikologët, të cilët përfunduan trajnimin, u pajisën me certifikatat dhe kartat identifikuese të pjesëmarrjes në trajnim, nga ana e Urdhrit të Psikologut. Listat me emrat e psikologëve të trajnuar si asistues dhe vlerësues u janë vënë në dispozicion Ministrisë së Drejtësisë dhe të gjithë rrjetit të institucioneve të drejtësisë dhe komisariateve të të gjithë Shqipërisë.

7. AKTIVITETET E URDHRI TË PSIKOLOGUT

Edhe pse një institucion i ri, Urdhri i Psikologut është angazhuar këtë vit në një sërë aktivitesh, si organizator dhe bashkë organizator. Disa nga aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2018 në rend kalendarik, janë si më poshtë:

- Konferenca I Ndërkombëtare “Psikologjia e shëndetit – Midis sfidave të zhvillimit dhe realitetit” – Tiranë, 19.01.2018



- Leksion i hapur “Yogga dhe efekti i saj pozitiv permanent në përditshmërinë tonë”, me profesorin e Yogga Luca Richards – Elbasan, 19.01.2018.



- Konferenca Rajonale e Psikologjisë “Me fëmijët ndërtojmë të ardhmen” – Lezhë, 05.03.2018



- Prezantimi i koordinators lokal për Qarkun Shkodër – Shkodër, 17.04.2018





- Prezantimi i koordinatorit lokal për Qarkun Lezhë – Lezhë, 25.04.2018



- Aktivitet i përbashkët me Unionin Studentor të Psikologjisë dhe Albanian University – Tiranë, 15.05.2018



- Prezantimi i koordinatorit lokal për Qarkun Korçë – Korçë, 27.04.2018.
- Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin publik “Luigj Gurakuqi” – Shkodër, 30.04.2018
- Aktivitet i përbashkët me Unionin Studentor të Psikologjisë – Elbasan, 09.05.2018
- Nisja e trajnimit të parë për psikologët në fushën e drejtësisë – Tiranë, 11.05.2018



- Aktivitet i përbashkët me Unionin Studentor të Psikologjisë dhe UET – Tiranë, 25.05.2018





- Workshop ndërinstitucional “Drejtësi miqësore për të gjithë fëmijët” – Tiranë, 10.07.2018



- Konferenca “Forcimi i kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë për të mitur” – Tiranë, 11.07.2018



- Takim ndërinstitucional “Drejtësia restauruese për të mitur” – Tiranë, 16.07.2018



- Event mbyllës për përfundimin e trajnimit të parë të psikologëve në fushën e drejtësisë për të mitur – Tiranë, 22.07.2018

- Asambleja II Kombëtare – Dajt, Tiranë, 27.07.2018



- Tryezë e përbashkët me “Terre des Hommes” – Tiranë, 07.08.2018
- Tryezë e përbashkët e Qendrës për Nismën Ligjore – Tiranë, 03.10.2018



- Nisja e trajnimit të dytë për psikologët në fushën e drejtësisë për të mitur – Tiranë, 05.10.2018



- Konferenca “Shëndeti mendor për të rinjtë në një botë që ndryshon” - Tiranë, 09.10.2018



- Event mbyllës i trajnimit të dytë të psikologëve në fushën e drejtësisë për të mitur dhe dorëzimi i titullit simbolik “Psikologu i vitit 2018” – Tiranë, 14.12.2018



- Konferenca “Mbrojtja e të dhënave personale” IDP – OSBE – Tiranë, 12.10.2018
- Takim me institucionet lokale dhe psikologët në Elbasan dhe Gramsh – Elbasan, Gramsh, 14.11.2018
- Takim me institucionet lokale dhe psikologët në Shkodër – Shkodër, 15.11.2018





- Takim me institucionet lokale dhe psikologët në Lezhë – Lezhë, 17.12.2018



- Urimi i fundvitit



8. MARRËDHËNIET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

8.1 Marrëdhëniet Kombëtare

Marrëdhëniet institucionale, sidomos me ministritë e linjës, por edhe me institucionet e varësisë së tyre, janë ngritur në nivel të qëndrueshëm dhe janë bazuar në plotësimin e nevojave institucionale.

- Pas insistimit të vazhdueshëm të Urdhrit të Psikologut, u arrit që në janar 2018 të miratohej Rregullorja e Praktikës Profesionale, e nënshkruar sipas ligjit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si autoritet kompetent, dhe Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë.

- Në shtator 2017, me ndryshimet në strukturën e qeverisjes kombëtare, përgjegjësia si autoritet kompetent për Urdhrin e Psikologut i kaloi Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Bashkëpunimi i ngushtë solli që në maj 2018 të miratohej Memorandumi i Bashkëpunimit midis dy institucioneve, që rregullonte përjashtimin e plotë apo të pjesshëm nga Praktika Profesionale për një kategori të gjerë psikologësh dhe që i hap rrugë realizimit për herë të parë të provimit të shtetit.



➤ Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka qenë thuajse i përditshëm për të rregulluar rolin e psikologut në drejtësi, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

U bashkërenduan përgjegjësitë për mënyrën e rregullimit të rolit të psikologut në implementimin e “Kodit penal për të mitur”, i cili hyri në fuqi në janar 2018 dhe për plotësimin e nevojave të sistemit të drejtësisë me

psikologë të trajnuar, të cilët thirren në cilësinë e ekspertit apo asistuesit.

Bashkëpunimi ka qenë i ngushtë edhe me të gjitha gjykatat e të gjithë niveleve në vend, si dhe me prokuroritë, drejtoritë e policeve, etj., të cilat kanë përkrahur institucionin në zbatimin e ligjit, për të mos përfshirë në proceset ligjore psikologë të pakualifikuar.

8.2 Marrëdhëniet Ndërkombëtare

Gjatë vitit 2018 ka vijuar puna për vendosjen e kontakteve dhe zgjerimin e bashkëpunimit me shoqatat e psikologëve, Urdhrat dhe oragnizatat e rëndësishme në Europë, e më gjerë.

- Në kuadër të krijimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, me ftesë të Presidentit të “Ordem dos Psicologes Portugueses” Urdhrit të psikologëve portugezë, Z.Francisco Rodrigues, u realizua në Lisbonë, më datë 9 shkurt 2018, një vizitë zyrtare pune. Kjo vizitë u bë e mundur pas një komunikimi intensiv disa mujor mes dy organizatave. Qëllimi i vizitës ishte eksplorimi i fushave të bashkëpunimit institucional dhe nxitja e aktiviteteve të përbashkëta, që mundësojnë përcjelljen e eksperiencës, asistencës teknike dhe ndihmën profesionale, nëpërmjet instrumenteve të qëndrueshëm.

Gjatë kësaj vizite, delegacioni pati nderin që të pritej në një takim pune nga Presidenti i “European Federation of Psychologists’ Associations” (EFPA) Z.Telmo Mourinho Baptista. Takimi u

realizua me kërkesë të vetë Presidentit dhe në fokus të këtij takimi u vu aplikimi i Urdhrit të Psikologut për të qenë anëtar i këtij organizmi dhe informimi i gjithë punës një vjeçare të kryer nga institucioni ynë.



Delegacioni, përvec takimit dypalësh me Presidentin Z.Francisco Rodrigues, realizoi gjithashtu takime me përfaqësues të tjerë të “Ordem dos Psicologos Portugueses” si me Drejtorin



e Marrëdhënieve me Publikun Z.Tiago Pereira, me Znj.Teresa Esspasandim, e cila ishte anëtare e Këshillit Kombëtar Portugez dhe përfaqësues të tjerë.



Gjatë kësaj vizite zyrtare, sipas rendit të dakordësuar, diskutimet u fokusuan në çështjet e mëposhtme:

- Ndarja e eksperiencës dhe diskutimi i nevojës së shërbimeve që Urdhri i Psikologut duhet të ofrojë për anëtarët e tij në kuadër të:
 - ndihmës për punësimin e psikologëve, duke ofruar vlerësim objektiv profesional të secilit prej tyre, si ndihmë për kërkuesit e shërbimit,
 - asistencës ligjore për çështjet profesionale,
 - Ndërmjetësimit për sigurimin e detyrueshëm të aktivitetit në kushte lehtësuese,
 - publikimit periodik të botimeve për shpërndarjen e informacionit dhe njohurive profesionale,
 - argëtimeve kulturore, sociale dhe sportive, me qëllim rritjen e frymës së kolektivitetit brenda profesionit.

- Negocimi i drejtpërdrejtë për përshejtimin e hapave për anëtarësimin në EFPA
- Organizimi i psikologjisë shkollore, legjislacioni përkatës, problematikat dhe hapsirat për bashkëpunim dypalësh.
- Organizimi i psikologjisë ligjore, legjislacioni përkatës, pikat e përbashkëta, problematikat në të dy vendet dhe hapsirat për bashkëpunim dypalësh.
- Asistencë për gjetjen e mundësive për përmirësimin e kuadrit rregullator në Shqipëri.





Gjatë takimeve të zhvilluara, u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit dhe të ndihmës për të cilat ka nevojë Urdhri i Psikologut në Shqipëri. Në këtë kuadër, Këshilli i Përgjithshëm Kombëtar Portugez i Psikologjisë, nëpërmjet Presidentit dhe drejtuesve të tjerë të rëndësishëm, u angazhuan në mënyrë të menjëhershme për:

- Ruajtjen e një komunikimi të vazhdueshëm institucional mes dy organizatave në nivelin më të lartë drejtues.
- Ndihmën me materiale orientuese dhe studime profesionale, të realizuara në fusha të ndryshme të psikologjisë.
- Angazhimin për ndërmjetësim të drejtpërdrejtë për përsheptimin e anëtarësimit në EFPA.
- Asistencë të vazhdueshme teknike të drejtpërdrejtë në nivel specialistësh
- Krijimin e mundësive për pjesëmarrje të anëtarëve të bordeve drejtues të Urdhrit të Psikologur në Shqipëri, në konferenca dhe kongrese rajonale, kombëtare dhe ndërkombetare, nën kujdesin e Këshillit të Përgjithshëm Portugez të Psikologjisë.



Kjo vizitë u finalizua me arritjen e një marrëveshje dakordësie ndërmjet Urdhrit Portugez dhe insitucionit tonë ku palët bien dakord për:

- Vijimin e komunikimit në lidhje me problematikat e përbashkëta.
- Kërkimin për të identifikuar projekte dhe aktivitete, nëpërmjet të cilave palët mund të punojnë sëbashku, të asistojnë, mbështesin njëra-tjetrën, si dhe të bashkëpunojnë për të mirën e psikologjisë dhe të interesit publik të cilat mund të përfshijnë, por pa u limituar në:
 - Mbështetje kombëtare dhe ndërkombëtare për aktivitete dypalëshe me qëllim promovimin e standardeve më të larta të praktikës në psikologji, edukim dhe kërkim shkencor.
 - Aktivitete akademike dhe profesionale të përbashkëta, duke përfshirë takimet profesionale, simpoziumet dhe grupet e punës.
 - Shkëmbimin e burimeve, produkteve, shërbimeve dhe përfitimeve individuale të anëtarëve të të dy institucioneve.
 - Vizita pune për t'u njohur me organizimin e punës së psikologëve në terren.





➤ Në korrespondencë të vazhdueshme me përfaqësues të Shoqatës Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë “European Association of Work and Organizational Psychology” (EAWOP) dhe me mbështetjen e plotë prej tyre, me qëllimin për t’u anëtarësuar me të drejta të plota, në maj 2018, një delegacion i Urdhrit ishte i ftuar në cilësinë e anëtarit në pritje, në takimin e anëtarëve të EAWOP që u mbajt në maj në Torino, Itali.



Gjatë takimi, Urdhri i Psikologur prezantoi arritjet e tij dhe gjendjen e psikologut organizacional dhe të punës në vendin tonë.



Nga drejtuesit e lartë të Shoqatës Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë u dhanë garancitë për pranimin e Urdhrit të Psikologut si anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë dhe dhënia e ndihmës për fuqizimin e rolit të psikologut organizacional në Shqipëri.

Në bashkëpunim me EAWOP synojmë të realizojmë ndryshime në legjislacionin shqiptar për një përfshirje të gjerë të psikologut organizacional në institucione dhe ndërmarrje publike dhe private në vend.





9. BUXHETI

9.1 TE ARDHURAT

Projekt-Buxheti i vitit 2018 parashikonte mbledhjen e të ardhurave në masën 11,850,000.00 lekë, nisur nga pritshmëria se do të kishte 300 regjistrime të reja, ndaj do të realizohej mbledhja e 950 kuotizacioneve vjetore dhe tarifa e licencimit për 250 psikologëve të rinj. Ndërkohë, buxhetin e vitit 2018 e ndihmonte edhe rezerva e krijuar nga viti 2017, në masën rreth 1.800.000 lekë.

Rezulton se përafërsisht, këtë vit fiskal nga 01/01/2018 deri më 31/12/2018, është realizuar përmbushja e të ardhurave si me poshtë:

Regjistrime: 285 anëtarë, në total 570,275 lekë.


Kuotizacione: 765 anëtarë, në total 4,570,005.00 lekë.

Licencime: 175 anëtarë, në total 2,625,000.00 lekë.

Shitja e Botimit të “Kodi i Etikës”:
në total 9,800.00 lekë.

Nga sa më sipër është realizuar një total të ardhurash prej rreth 7,775,080.00 lekë. Duke patur parasysh dhe rezervën e vitit 2017, prej 1,850,000.00 lekë, zëri i të ardhurave është përmbushur në masën e 78% të projekt buxhetit 2018.

Të Ardhura 2018





9.2 SHPENZIMET

Nisur nga eksperiencia e vitit të kaluar, për efekt të disiplinimit sa më transparent të të ardhurave, kemi ruajtur një balancë të shpenzime të detyrueshme për t'u realizuar sipas planifikimit.

Shpenzimet për pagat kanë një rritje të vogël nga viti paraardhës, pasi për shkak të mbingarkesës së pozicionit të sekretari/protokoll/arshivës, u miratua që paga mujore e këtij pozicioni të barazohet me specialistët e tjerë të administratës, ndërsa pagat e tjera të mbeten të pandryshuara.

Në zërin e shpenzimeve operative, janë pasqyruar, bazuar në vitin e kaluar, shpenzimet bazë si kancelari, materiale, elektricitet, ujë, qiramarrje, mirëmbajtje, shërbime bankare, postë, etj.

Në këtë kategori janë shtuar disa zëra si:

- prodhim dokumentacioni special (karta dhe licenca),
- shpenzime për ekspertët e jashtëm (ekspert kontabël i kërkuar nga ligji për mbylljen dhe dorëzimin e bilancit në organet tatimore, audit i jashtëm i kërkuar nga ligji, etj.),
- shërbime përkthimi,
- software dhe programe (për dixhitalizimin e të gjithë dokumentacionit të arshivuar për secilin psikolog dhe shfaqjen e tyre online në kuadër të rritjes së transparencës; përmirësimit të

regjistrave online dhe automatizimin e tyre në një të vetëm, në ndërveprim me serverat e ministrive të linjës; etj.),

- shpenzime për aktivitet kombëtare (përfshirë mbledhjet e Asamblesë) dhe ndërkombëtare, (një pjesë e të cilave janë të programuara dhe të konfirmuara për vitin në vijim).

- shpenzim për anëtarësim në organizata ndërkombëtare (tarifë anëtarësimi si vend kandidat për EFPA, EAËOP, etj.),

- shpenzime për pjesëmarrje në konferenca, samite, kongrese, me qëllim faktorizimin e mëtejshëm të Urdhrit të Psikologut në arenën ndërkombëtare, etj.

Shpenzimet e viti aktual janë kryer në përputhje me projekt-buxhetin e miratuar, sipas zërave, dhe nga data 01/01/2018 deri me 31/12/2018 rezultojnë si më poshtë:

Paga - në masën e rreth 3,308,000.00 lekë sic ishte e parashikuar në projekt buxhet.

Shpenzime operative - në masën rreth 5,549,832.52 nga 7,692,000.00 të parashikuara ne projekt buxhet

Shpenzime kapitale -në masën rreth 342,920.00 lekë nga 500,000.00 të parashikuara ne projekt buxhet

Me një total shpenzimesh rreth 9,200,752.52 lekë zëri i shpenzimeve është ezauruar në masën 124.9% të shpenzimeve të ardhurave faktike, të



mbledhura deri më 31/12/2018, duke prekur rezervat e vitit të kaluar në masën 1,425,672.52 lekë.

Buxheti faktik i vitit 2018 ruan një balancë të qëndrueshme midis të ardhurave dhe shpenzimeve, duke vijuar ruajtjen e stabilitetit ekonomik të institucionit, si dhe reflekton ambicien për të kaluar në një fazë të re të

funksionimit të Urdhrit, me qëllim që aktiviteti i tij të bëhet sa më i ndjeshëm në politikat kombëtare dhe ndërkombëtare, të jetë sa më i prekshëm për anëtarësinë dhe, mbi të gjitha, të përmbushë misionin ligjor për të cilin është krijuar në bazë të ligjit 40/2016 për “Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

Tabela Përmbledhëse

Emertimi	Vlera	Monedha
Rezerva nga viti i kaluar	1,800,000.00	ALL
Te ardhura	7,775,080.00	ALL
Total	9,575,080.00	ALL
Shpenzime:		
Paga	3,308,000.00	ALL
Shpenzime operative	5,549,832.52	ALL
Shpenzime kapitale	342,920.00	ALL
Total	9,200,752.52	ALL

10. OBJEKTIVAT E REALIZUAR GJATË VITIT 2018

- Rritja e anëtarësimeve në Urdhrin e Psikologut, nëpërmjet ndërgjegjësimit, sensibilizimit dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet.
- Miratimi i akteve nënligjore për rregullimin e mënyrës së kryerjes së praktikës profesionale dhe të provimit të shtetit.
- Njohja dhe zbatimi i Kodit të Etikës dhe Deontologjisë së Psikologut në çdo aspekt të ushtrimit të profesionit.

- Përcaktimi dhe ndërtimi i një kuadri normativ për rregullimin e sistemit të edukimit në vazhdim për psikologët.
- Fillimi i punës për ngritjen e rrjetit të koordinatorëve lokal ose zyrave rajonale të Urdhrit.
- Bashkëpunim me të gjitha Ministrinë e linjës, lidhur me ngritjen e strukturave psiko-sociale për implementimin e ndryshimeve ligjore në fushën e drejtësisë penale, të cilat



parashikojnë përfshirjen e specialistit psikolog në proces.

- Rritja e bashkëpunimit në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke

synuar marrjen e statusit të vendit kandidat në Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (“EAWOP”).

11. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019

- Realizimi i provimit të parë të shtetit për profesionin e psikologut.
- Fuqizimi i rolit dhe statusit të psikologut në institucione, nëpërmjet miratimit të protokolleve të punës për secilën fushë të kompetencës.
- Shtrirja e rrjetit të koordinatorëve lokalë.
- Sensibilizimi mbi rolin e psikologut organizacional dhe ndërmarrja e nismave për aplikimin në vend të psikologjisë organizacionale në institucione publike dhe private.
- Bashkëpunim të ngushtë me pushtetin qendror dhe lokal, jo vetëm në fuqizimin e rolit të psikologut, por

edhe në projekte të përbashkëta në nivel lokal dhe kombëtar, të cilat do të faktorizojnë punën e psikologut.

- Implementim i projekteve të përbashkëta me institucionet ndërkombëtare për fuqizimin dhe përmirësimin e rolit të psikologut në vend.

- Marrja e statusit të vendit anëtarë me të drejta të plota në Shoqatën Europiane të Psikologëve të Punës dhe Organizacionalë (EAWOP).

- Marrja e statusit të vendit kandidat në Federatën Europiane të Shoqatave të Psikologëve, (European Federation of Psychologists’ Associations “EFPA”).